



Udhërrëfytesë për e-Legislation



Korrik 2018

OSBE organizoi takime pune në Parlamentin austriak për një delegacion nga Kuvendi (deputetë dhe staf), me qëllimin e marrjes së njohurive mbi procesin elektronik të ligjbërjes në Austri (E-law).



Shkurt 2019

Për të prezantuar stafin me modelet më të mira ndërkombëtare, OSBE mbështeti pjesëmarrjen e tyre në Simpoziumin "InternationalRechtsinformatik" në Salzburg, Austri. Simpoziumi ishte një mundësi që stafi të fitonte njohuri mbi çështjet kryesore të informatikës ligjore.



Shtator 2019

Stafi i Kuvendit fitoi njohuri mbi standardet më të rëndësishme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për legjislacionin, si dhe për dokumentet gjyqësore, parlamentare dhe administrative. Stafi mësoi ndikimin e TIK-ut në fazat e ndryshme të procesit legjislativ dhe administrativ.



Shkurt 2020

OSBE organizoi tri sesione informuese mbi sistemin "E-legislation" për deputetët dhe stafin e Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të ekzekutivit, akademikë dhe shoqërinë civile (rreth 120 persona në 3 sesione të ndryshme, 70 f, 50 m).

Proçesi i konsultimit

197

Pjesëmarrës në procesin e konsultimit

540

Minuta diskutime mbi kuadrin e-Legislation

5

Target grupe, përfshi këtu Kuvendi, OSHC-të, të rinjtë, akademikë, qeveria.

Qershor 2020



- Kuvendi zgjodhi Akoma Ntoso si një standard ndërkombëtar të certifikuar për t'u përdorur në procesin legjislativ;
- Akoma Ntoso përcakton një grup teknologjikisht neutral në formatin XML për dokumente parlamentare, ligjore dhe gjyqësore dhe është certifikuar nga OASIS.



Nëntor 2020

Në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët nga Instituti Kërkimor Alma Mater për Inteligjencën Artificiale në Universitetin e Bolonjës, Prezenca filloi përshtatjen e Akoma Ntosos për kërkesat specifike të dokumenteve parlamentare dhe normative të Shqipërisë (AKN4AL).



Akoma Ntoso për Shqipërinë (AKN4AL) është zhvilluar dhe tashmë është standardi zyrtar për përshkrimin e dokumentave të procesit ligjor.



Support to Parliament and
Civic Education in Albania

Mbështetje për Parlamentin
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

Më 9 prill, Kuvendi ka krijuar një Task Forcë për të monitoruar procesin, e cila përfshin përfaqësues nga Kuvendi, Prezenca e OSBE, Këshilli i Ministrave, Presidenca, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, Zyra e Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Qendra e Botimeve Zyrtare




Duke filluar nga Nëntor 2021
Dixhitalizimi



Me mbështetjen teknike nga Projekti, dokumentet e shkuara parlamentare do të dixhitalizohen duke përdorur AKN4AL për t'i bërë ato pjesë të kuadrit e-Legislation.

Nëntor 2021-Maj 2022
Krijimi i motorit të kërkimit



Një motor kërkimi do të krijohet bazuar në bazën e dokumenteve të përcaktuara në standarting AKN4AL dhe do të integrohen në faqen zyrtare të Kuvendit. Motori i kërkimit do të rrisë transparencën, aksesin e publikut dhe kërkimin e avancuar për ligjet e konsoliduara

Tetor-Dhjetor 2021
Krijimi i moduleve të nevojshme për të filluan punën në e-Legislation



Zhvillimi i ndërfaqeve do të bëhet sipas nevojës për të mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e dokumenteve mes programeve të ndryshme që përdoren aktualisht në procesin legjislativ.

Mars 2022- në vazhdimësi
përgatitja e procesit të dixhitalizimit



Mbështetje për Parlamentin në menaxhimin e procesit të dixhitalizimit që do të zbatohet në përputhje me planin e përgatitur nga kompani/ekspertë të jashtëm. Synohet dokumentat parlamentare nga legjislatura 2017-2021 dhe në vazhdim. Kjo lidhet ngushtësisht me rezultatet e Lokalizimit dhe planin e detajuar (të përgatitur në seksionin 12) për zbatimin e procesit të dixhitalizimit dhe afateve kohore.

Projekti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri" mbështetet nga qeveria Zviceriane dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri